



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 499/1 prot.

Tiranë, më 06.02.2025

Lënda: Dhënie mendimi mbi *“Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile”*

AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj nr. 184 prot., datë 28.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 499 prot., datë 29.01.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim draftin e marrëveshjes së bashkëpunimit, mes Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, lidhur me mënyrën e përdorimit dhe procedurat specifike të shfrytëzimit të të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim *“projekt marrëveshja”*).

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit, pas analizimit të legjislacionit specifik, në zbatim të të cilit ushtroni veprimtarinë, konkretisht ligjit nr. 65/2014 *“Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”*, i ndryshuar, vëren se Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (në vijim *“AISM”*), legjitimohet të administrojë dhe të mbledhë informacione përmes Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim *“RKGJC”*).

Megjithatë, sugjerojmë që, edhe pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, AISM, në cilësinë e kontrolluesit, në zbatim të pikës 12, të Udhëzimit të përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 *“Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”*, i ndryshuar, duhet të ndër marrë masa për paraqitjen e kërkesës për përfshirjen e institucionit, në Aneksin 1 (*Lista e institucioneve që marrin informacion, baza ligjore përkatëse, lloji dhe sasia e informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyra e vënies në dispozicion të këtij informacioni*), të këtij Udhëzimi.

Nga shqyrtimi i materialit të vendosur në dispozicion, Zyra e Komisionerit konstaton se, në tekstin e projekt marrëveshjes citoni dhe referoni në parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Për rrjedhojë, ju bëjmë me dije se, aktualisht ka hyrë në fuqi ligji i ri nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji nr. 124/2024”), i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm. Ligji nr. 124/2024 është baza e re ligjore, e përafuar me legjislacionin e BE-së, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 dhe Direktivën e Policisë 2016/680, me qëllim përforcimin dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit sugjeron të merrni masa për përditësimin dhe saktësimin e bazës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, duke zëvendësuar togfjalëshin “ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, me togfjalëshin “ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale””.

Ndërkohë, duke vlerësuar se një ndër qëllimet e kësaj projekt marrëveshje është përcaktimi i procedurave dhe mënyrës së përdorimit të të dhënave të aksesuara, me qëllim përmbushjen e një detyrimi të parashikuar ligjor, sugjerojmë që, **në nenin 3 të projekt marrëveshjes, të shtohet një pikë** ku të përcaktohen kategoritë e të dhënave që do të grumbullohen, me qëllim që të përpunohen vetëm ato të dhëna që janë të përshtatshme dhe të nevojshme për qëllimin e përpunimit, në zbatim të parimit të minimizimit të të dhënave, parashikuar në pikën 3, të nenit 6 të Ligjit nr. 124/2024.

Në vijim, Zyra e Komisionerit, sugjeron që, **pika 2 dhe 3, e nenit 5 të projekt marrëveshjes**, të riformulohen duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, politikat e vendosjes së fjalëkalimeve dhe afatet e përditësimit periodik të tij.

Në mbështetje të parashikimeve të nenit 28, të Ligjit nr. 124/2024, sugjerojmë që, **në nenin e sipërcituar, të shtohet një pikë** me formulimin, si vijon: “*AISM, në çdo rast zbaton masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, duke siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, sipas parashikimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i **nenit 6 të projekt marrëveshjes**, rezulton se i referoheni konfidencialitetit të të dhënave, për këtë arsye, Zyra e Komisionerit, sugjeron që titulli i këtij neni të ndryshohet nga “*siguria e të dhënave*”, në “*konfidencialiteti i të dhënave*”.

Më tej, në mbështetje edhe të pikës 2, të nenit 6 të Ligjit nr. 124/2024, sugjerojmë që, **në pikën 1, të nenit 6 të projekt marrëveshjes**, ku citohet se: “*Informacioni i marrë nga përdorimi i sistemit nuk duhet të përdoret për qëllime personale*”, në fund të fjalisë, të

shtohet togfjalëshi me përmbajtje: “...si dhe nuk duhet të tejkalojë qëllimin fillestar për të cilën është mbledhur”.

Duke qenë se respektimi i parimeve dhe standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale përbën një detyrim thelbësor, do të vlerësonim marrjen në konsideratë nga ana juaj të sugjerimeve të mësipërme.

Me reflektimin e sa më sipër, Zyra e Komisionerit e vlerëson marrëveshjen, të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe shprehet dakord për miratimin e saj.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi